



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.972/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Afijete Sada Gllogjani kryesuese, Zyhdi Haziri dhe Kymete Kicaj anëtar, duke vendosur përkitazi me apelin e parashtruar nga votuesi Fatmir Povataj, paraqitur kundër vendimit me numër 2948-2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021, për Kuvendin Komunal, në seancën e panelit të mbajtur më datë 07.11.2021, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet i pabazuar apeli Anr.972/2021 i datës 04.11.2021, i parashtruar nga votuesi Fatmir Povataj, paraqitur kundër vendimit me numër 2948-2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021, për Kuvendin Komunal, me të cilën ka kërkuar Rinumërimin e votave në vendvotimin 105C/03R.

A r s y e t i m

PZAP-i, me datë 04.11.2021, ka pranuar apelin Anr.972/2021, i ushtruar nga votuesi Fatmir Povataj, me të cilën ndër të tjera pretendon se ka votuar subjektin politik numër 121 dhe kandidatin për asamble të kësaj partie me numër 04 Erdogan Dautaj, dhe pas publikimit të rezultateve kandidati në fjalë ka zero (0) vota.

PZAP-i, pas shqyrtimit të apelit, vlerësimit të pretendimeve ankimore, dhe në kuptim të nenit 105 paragrafi 1, dhe nenit 117 paragrafët 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Apeli është i pa bazuar

Nga shkresat e lëndës, rezulton fakti se apeluesi, Fatmir Povataj, kërkon rinumërimin e votave në vendvotimin 105C/03R, Paneli pas shqyrtimit të apelit erdhi në përfundim se apeli i ushtruar nga apeluesi, është i pa bazuar.

Paneli, vlerëson se parashtruesi i apelit në mbështetje të pretendimeve të tij, nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse lidhur me shkeljet e supozuara për mospërputhje të rezultateve, i njëjti nuk, e ka specifikuar saktë vendvotimin në të cilin ka pretenduar se ka parregullsi. Në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, në rastin konkret, paneli, nuk mundi të konstatoj vendvotimin për shkeljen e pretenduar për kandidatët të

këtij subjekti politik, ashtu siç pretendon ankuesi, për faktin se thëniet e tij nuk mbështetën në asnjë provë konkrete dhe të njëjtat janë vetëm pretendime dhe nuk argumentohen me asnjë prove.

Paneli vlerësoi se apeli i parashtruar, nuk është bazuar në dëshmi të qarta dhe bindëse ashtu siç përcaktohet në nenin 117 par.3, të LZP-së, pasi që nga shkresat e lëndës nuk mund të vërtetohet vendvotimi i shkeljes se pretenduar.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë e në kuptim të neneve 115 paragrafi 1, 117 dhe 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Anr.972/2021 më datën 07.11.2021

Kryesuesja e Panelit
Afijete Sada Gllëgjani



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimimit të këtij vendimi.